

Publikimi I Raporteve Financiare - Rregullorja 60

Përmbajtja

1.	Informacion mbi aktivitetin kryesor, organizimin, drejtimin dhe kontrollin e bankave	3
2.	Bilanci kontabël, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe në veçanti tregues të rentabiliteti.....	5
3.	Struktura e kapitalit rregullator	11
4.	Mjaftueshmëria e Kapitalit	12
5.	Informacion i përgjithshëm cilësor për ekspozimin ndaj rreziqeve.....	14
6.	Rreziku i kredisë: Informacion i përgjithshëm	15
7.	Rreziku i kredisë : Informacion për portofolin e kredisë sipas metodës standard	17
8.	Teknikat e zbutjes së rrezikut	18
9.	Rreziqet e tregut: Informacion i përgjithshëm	18
10.	Rreziku operacional	18
11.	Rreziku i likuiditetit.....	19
12.	Depozita ekuivalente e kapitalit të degës së bankës së huaj	20
13.	Matja dhe kontrolli i kufijve të rrezikut të degës së bankës së huaj	20
14.	Politikat kontabël.....	21


1. Informacion mbi aktivitetin kryesor, organizimin, drejtimin dhe kontrollin e bankave

1.1	Informacion i Pergjithshem mbi Banken:
a) Emri i Subjektit Forma ligjore Zyra qendrore e shoqërisë në Shqiperi Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS) Data e Regjistrimit	Banka NGB Albania Shoqëri Aksionare Rruga "Dritan Hoxha", Hd.8, H.1, Njesia Bashkiake Nr.11, Kodi Postar 1026, Tirane J61911008C 12/06/1996
b) Kapitali i regjistruar	7,587,914,546.30 ALL
c) Kapitali i paguar	7,587,914,546.30 ALL
d) Tipi i aksioneve Numri i aksioneve Vlera Nominale	Te zakonshme 58,851,664.00 128,93
e) Informacion mbi rritjen e Kapitalit	Më 22 nëntor 1995 Banka nisi aktivitetin e saj me një kapital fillestar prej 2 milion USD si një kontribut i National Bank of Greece S.A (NGB S.A.). Ky kontribut, duke përdorur kursin historik të këmbimit USD/LEK prej 100, është ekuivalent me 200,000,000 LEK. Pas disbursimit fillestar të kapitalit kanë pasuar rritjet e mëposhtme në kapitalin e paguar nga aksionari i vetëm, NGB S.A.: Më 1 nëntor 1999: USD 1,721,483; Më 6 prill 2001: USD 1,376,424; Më 17 korrik 2003: EUR 1,693,050; Më 26 nëntor 2004: EUR 1,000,000; Më 14 prill 2006: EUR 5,000,000; Më 7 janar 2008: EUR 15,000,000; Më 25 qershor 2009: EUR 20,000,000; Më 19 dhjetor 2011: EUR 5,000,000 Më 23 nëntor 2012: EUR 3,000,000
1.2	Informacion mbi aksionerin
a) Aksioner- Person Juridik: Numri i Aksioneve me te drejte vote Përqindja e pjesëmarrjes	Banka Kombetare e Greqise 58,851,664 100

Informacion mbi Aktivitetin e Bankes

Banka mund te kryeje veprimtarite : pranimin e depozitave dhe fondeve te tjera nga publiku; te gjitha format e kredidhenies duke perfshire edhe kredine konsumatore e kredine hipotekare;qirane financiare;te gjithë shërbimet e pagesave dhe te transferimit te parave, duke perfshire kartat e kreditit dhe te debitit, çeqet e udhetarit, çeqet bankare dhe kartat e pageses; ofrimin e garancive dhe marrjen e angazhimeve; tregtimin per llogari te saj ose per llogari te klienteve qofte edhe ne nje kembim valutor ne nje treg te vetorganizuar ose ndryshme si me poshte : instrumente te tregut te parase (çeqe, deftesa, çertifikata te depozitave, etj); kembim valutor, produkte derivative (instrumente derivative), duke perfshire, midis te tjerave kontrata te se ardhmes dhe kontrata me opsione; letra me vlere te transferueshme;instrumente te tjera te negociueshme dhe aktive financiare duke perfshire veprimet me arin;pjesemarrjen ne emetimin e te gjitha llojeve te letrave me vlere duke perfshire nenskrimin dhe vendosjen si agjent (si publik ashtu edhe privat) dhe kryerjen e shërbimeve lidhur me keto emetime; instrumente te kembimeve valutore dhe instrumente per vleresimin e normes se interesit duke perfshire marreveshje swap dhe marreveshje qe percaktojne vleren e interesit ne te ardhmen; ofrimin e shërbimeve te kasetave te sigurise; ndermjetesimin per transaksionet monetare te meposhtme: administrimin e aktiveve te tilla si administrimi i parave dhe i portofolit, administrimi i fondeve, marrja ne kujdestari, shërbimet depozituese dhe te besimit; shërbimin per kompesimin dhe shlyerjen e pagesave te aktiveve financiare duke perfshire letrat me vlere, produktet derivative dhe instrumente te tjera te negociueshme; sigurimin dhe transferimin e informacionit financiar si dhe perpunimin e te dhenave financiare e te programeve qe kane lidhje me te nga furnizuesit e shërbimeve te tjera financiare; shërbimet keshilluese,ndermjetesuese dhe shërbime te tjera ndihmese per te gjitha veprimtarite e listuara ne shkronjat "b" dhe "g" te ketij neni duke perfshire referencen e kredise dhe te analizes, kerkimin dhe keshillimin ne lidhje me investimet dhe portofolin, si dhe keshillimin mbi blerjet e mbi strategjine dhe ristrukturimin e shoqerive; vepron si regjistruer i Titujve Qeveritare. Banka do te kete te drejten te organizoje dhe administroje regjistrin e Titujve sipas udhezimeve dhe rregulloreve te Komisionit te Titujve. Banka do te ofroje shërbimin e regjistrimit te titujve qeveritare dhe titujve te tjere te percaktuara sipas ligjit Nr. 9879 date 21.02.2008 (Per Titujt) me qellim qe te sigutoje ne cdo kohe informacion rreth pronesise mbi titujt dhe kufizime te vendosura mbi te drejttat e pronesise dhe veprimtari te tjera financiare te percaktuara nga termat ne licensen e bankes te leshuar nga Banka e Shqiperise.

Struktura Organizative



2. Bilanci kontabël, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe në veçanti tregues të rentabiliteti

2.1 Bilanci Kontabel

Kodi	AKTIVET (Ne Mije Lek)	TOTALI
1	VEPRIMET ME THESARIN DHE TRANSAKSIONET NDERBANKARE	12,093,399.94
11	Arka dhe Banka qendrore	5,233,418.21
	Arka	1,142,116.85
	Banka qendrore	4,091,301.36
	Llogarite rrjedhese	1,404,036.91
	Rezerva e detyrueshme	2,687,264.45
12	Bono thesari dhe bono te tjera te pranueshme per rifinancim me Banken Qendrore	3,340,605.80
	Bono thesari*	3,408,283.09
	Skonto/Shtesa**	-110,983.95
	Interesi i perlllogaritur	43,306.66
13	Llogari rrjedhese ne bankat, instituc. e kreditit dhe instituc. e tjera financiare	1,555,388.49
	Llogari rrjedhese ne bankat, instituc. e kreditit dhe instituc. e tjera financiare rezidente	10.90
	Llogari rrjedhese ne bankat, institucionet e kreditit dhe institucione te tjera financiare jorezidente	1,555,377.59
14	Depozita me bankat, institucionet e kreditit dhe institucione te tjera financiare	1,963,987.44
	me afat	1,964,060.00
	interesi i perlllogaritur	-72.56
2	VEPRIMET ME KLIENTET	19,526,849.50
20	Hua standarte dhe paradhenie per klientet	15,693,816.06
	Hua afatshkurter	2,333,691.19
	Hua afatmesme	1,267,347.95
	Hua afatgjate	1,829,866.68
	Hua per prona te patundshme (hipotekare)	10,262,910.23
22	Hua dhe paradhenie ne ndjekje	2,609,425.28
	Hua afatshkurter	53,335.71

	<i>Hua afatmesme</i>	804,108.78
	<i>Hua afatgjate</i>	77,109.69
	<i>Hua per prona te patundshme (hipotekare)</i>	1,674,871.10
23	Hua nenstandart	579,838.31
	<i>Hua afatshkurter</i>	74,073.86
	<i>Hua afatmesme</i>	76,981.64
	<i>Hua afatgjate</i>	46,675.05
	<i>Hua per prona te patundshme (hipotekare)</i>	541,408.35
	<i>Fonde rezerve per mbulimin e humbjeve nga huate nenstandart</i>	-159,300.58
24	Hua te dyshimta	643,769.85
	<i>Hua afatshkurter</i>	262,418.82
	<i>Hua afatmesme</i>	631,558.40
	<i>Hua afatgjate</i>	228,216.19
	<i>Hua per prona te patundshme (hipotekare)</i>	201,069.50
	<i>Fonde rezerve per mbulimin e humbjeve nga huate e dyshimta</i>	-679,493.06
25	Hua te humbura	0.00
	<i>Hua afatshkurter</i>	1,078,258.64
	<i>Hua afatmesme</i>	692,330.10
	<i>Hua afatgjate</i>	406,971.16
	<i>Hua per prona te patundshme (hipotekare)</i>	885,624.75
	<i>Fondet rezerve per mbulimine e humbjeve nga huate e humbura</i>	-3,063,184.64
3	VEPRIME ME LETRAT ME VLERE	3,905,818.12
	<i>Letra me vlere te vendosjes</i>	3,905,818.12
	<i>Letra me vlere te vendosjes</i>	3,855,201.98
	<i>Interesi i perlogaritur si e ardhur</i>	50,616.14
4	MJETE DHE DETYRIME TE TJERA	494,934.25
	<i>Debitore te ndryshem</i>	244,850.97
	<i>Te ardhura te llogaritura dhe shpenzime te shtyra</i>	101,851.90
	<i>Llogari pezull dhe te pozicionit</i>	148,231.38
5	MJETET E QENDRUESHME DHE BURIMET E PERHERSHME	130,766.15
53	Mjete te qendrueshme	130,766.15
	<i>Mjetet e patrupezuara</i>	379,069.78
	<i>Amortizimi i mjeteve te patrupezuara</i>	-344,770.63
	TOTALI	36,151,767.95

Bazuar ne te dhenat e muajit Qershor 2015, me siper jepet i detajuar pasqyra e aktivitet me kodet e percaktuara sipas "Sistemit te Raportimit te Unifikuar".

Zerat kryesore te aktiveve jane si me poshte shenuar:

1. Veprime me thesarin dhe transaksione nederbankare
2. Veprime me klientet
3. Veprime me letra me vlere
4. Mjete te tjera
5. Mjete te qendrueshme

Gjate muajit Qershor 2015, Banka ka fshire nga Bilanci Kredi te cilat kane rezultuar ne Proces Ligjor per me shume se 3 vjet.

Kodi	PASIVET (Ne Mije Lek)	TOTALI
1	VEPRIMET E THESARIT DHE TRANSAKSIONET NDERBANKARE	2,486,506.50
12	Bono thesari dhe bono te tjera te pershtatshme per rifinancim me Banken Qendrore	1,824,559.99
	Bono te shitura sipas marreveshjes se riblerjes	1,822,873.00
	Interesi i perlllogaritur	1,687.00
13	Llogari rrjedhese me bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare	51,066.88
	<i>Llogari rrjedhese ne bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare rezidente</i>	29,922.12
	<i>Llogari rrjedhese ne bankat, instituc. e kreditit dhe instituc. e tjera financiare jorezidente</i>	21,144.76
16	Depozita nga bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare	231,109.06
	<i>Depozita nga bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare rezidente</i>	231,109.06
	Depozita me afat	229,814.81
	Interesa te perlllogaritura	1,294.25
17	Hua marre nga bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare	379,770.57
	<i>Hua marre nga bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare rezidente</i>	360,020.22
	Hua marre nga Bankat	360,000.00
	Interesi i perlllogaritur	20.22
	<i>Hua marre nga bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare jorezidente</i>	19,750.35
	Hua me afat marre nga bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare	19,750.00
	Interesi i perlllogaritur	0.35
2	VEPRIMET ME KLIENTET	28,027,542.78
26	QEVERIA SHQIPTARE DHE ADMINISTRATA PUBLIKE	294,058.26
	<i>Llogari rrjedhese me Qeverine Shqiptare dhe administraten publike</i>	200,564.25
	Qeveria Qendrore	563.36
	Qeveria Rajonale	36,368.78
	Qeveria Lokale	0.00
	Te tjera	163,632.11
	<i>Depozitat me afat nga Qeveria shqiptare dhe administrata publike</i>	23,017.93
	Te tjera	23,087.03
	Interesi i perlllogaritur	-69.10
	<i>Hua te marra nga Qeveria shqiptare dhe administrata publike</i>	70,476.08
	Qeveria Qendrore	70,475.10
	Interesi i perlllogaritur	0.98
27	Detyrime ndaj klienteve per llogarite rrjedhese dhe depozitat	27,620,186.76
	<i>Llogari rrjedhese</i>	4,818,021.13
	<i>Llogari depozitash pa afat</i>	1,883,071.86
	<i>Llogari depozitash me afat</i>	20,919,093.77
274	Certifikatat e depozitave	0.00

28	Llogari te tjera te klienteve	113,297.76
	<i>Llogari per mbulimin e ceqeve</i>	0.00
	<i>Llogari garancie</i>	0.00
	<i>Llogari te bllokuara per garanci</i>	113,297.76
3	VEPRIME ME LETRAT ME VLERE	0.00
33	Borxh i perfaqesuar nga letrat me vlere	0.00
34	Letra me vlere te blera dhe te shitura sipas marreveshjes se riblerjes	0.00
4	MJETE DHE DETYRIME TE TJERA	695,348.81
42	Detyrime te tjera	109,064.21
	<i>Kreditore te ndryshem</i>	55,999.11
	<i>Tatimi per t`u paguar</i>	10,536.26
	<i>Te tjera</i>	45,462.85
	<i>Shpenzime te llogaritura dhe te ardhura te shtyra</i>	53,065.10
43	Transaksionet si agjente	109,686.85
	<i>Doganat</i>	43,230.37
	<i>Transaksione te tjera si agjent</i>	66,456.49
44	Llogarite e marredhenieve	0.00
45	Llogarite pezull dhe te pozicionit	476,597.74
	<i>Llogarite pezull</i>	476,597.74
46	Tatimi i vleres se shtuar	0.00
5	MJETE TE QENDRUESHME DHE BURIME TE PERHERSHME	4,942,369.86
54	Ndihma dhe financimi publik	0.00
55	Fondet rezerve specifike	436,495.31
	<i>Fonde rezerve per humbjet e mundshme ne lidhje me angazhimet e dhena</i>	9,386.46
	<i>Fonde rezerve per gjobat</i>	0.00
	<i>Fonde rezerve per rrezikun statistikor per mbulimin e humbjeve nga huate standarte & ne ndjekje</i>	339,627.33
	<i>Fonde rezerve te tjera</i>	87,481.52
56	Borxhi i varur	1,683,754.03
	<i>Borxhi i varur</i>	1,683,480.00
	<i>Interesi i perlllogaritur</i>	274.03
57	Kapitali i aksionereve	2,822,120.52
	<i>Kapitali i paguar</i>	7,587,914.55
	<i>Primet e aksioneve</i>	0.00
	<i>Rezerva</i>	395,878.30
	<i>Diferenca e rivleresimit</i>	487,570.47
	<i>Fitimi (humbja) i pashperndare</i>	-5,717,044.09
	<i>Fitimi (humbja) i vitit ushtrimor</i>	67,801.29
	TOTALI	36,151,767.95

Kodi	ZËRAT JASHTË BILANCIT (në Mijë Lek)	TOTALI
90	90. ANGAZHIME FINANCIMI	919,512.41
901	901. Angazhime të dhëna	919,512.41
9011	9011. Institucioneve të kreditit	334,949.51
9012	9012. Klientëve	584,562.90
902	902. Angazhime të marra	0.00
9021	9021. Institucioneve të kreditit	0.00
9022	9022. Klientëve	0.00
91	91. GARANCITË	63,870,245.22
911	911. Garanci të dhëna	215,520.92
9111	9111. Institucioneve të kreditit	0.00
9112	9112. Klientëve	215,520.92
912	912. Garanci të marra	63,654,724.30
9121	9121. Institucioneve të kreditit	92,129.38
9122	9122. Klientëve	63,562,594.92
94	94. ANGAZHIME TË TJERA	7,720,024.47
941	941. Angazhime të dyshimta	7,720,024.47
942	942. Të tjera	0.00
	TOTALI	72,509,782.10

2.1. Pasqyra e llogarise “ Te ardhura dhe Shpenzime”

Kodi	LLOGARIA FITIM E HUMBJE (në Mijë Lek)	TOTALI
60	Shpenzime te veprimtarise bankare	278,662.15
601	Shpenzime për interesa	275,678.94
	Për veprimet e thesarit dhe ndërbankare	7,238.44
	Për veprimet me klientët	159,139.90
	Për borxhe që përfaqësohen nga letrat me vlerë	0.00
	Për borxhet e varura	51,520.17
	Për letrat me vlerë të shitura sipas marrëveshjeve të riblerjes	11,171.47
	Të tjera (prim per ASD)	46,608.96
	Komisione	2,983.21
	Komisione për shërbime bankare	2,534.14

	Komisione të tjera	449.06
61	Shpenzime për personelin	213,997.73
62	Taksa të tjera përveç taksave mbi të ardhurat	3,879.30
63	Shpenzime te pergjithshme te veprimtarise	242,191.89
64	Amortizimi dhe fondet rezervë për zhvlerësimin e Mj. të Qëndr.	32,135.44
	Shpenzime amortizimi	32,135.44
	Fonde rezervë	0.00
65	Humbje nga llogaritë për t'u arkëtuar të pambledhshme shpenzime për fonde rezervë	547,628.23
651	Shpenzime për fonde rezervë statistikore për huatë standarte & në ndjekje	29,305.56
	Standarte	15,915.34
	Në ndjekje	13,390.21
652	Shpenzime për fonde rezervë për huatë nënstandarte, të dyshimta & të humbura.	516,667.14
	Nënstandart	45,679.26
	Të dyshimta	119,685.31
	Të humbura	351,302.58
	Llogari për t'u arkëtuar të pambledhshme	1,655.53
66	Shpenzime të jashtëzakonshme	4,172.12
67	Taksa mbi të ardhurat	0.00
69	Fitimi i vitit në vazhdim	67,801.29
	TOTALI I SHPENZIMEVE	1,390,468.14
70	Te ardhura te veprimtarise bankare	1,018,529.51
701	Të ardhura nga interesat	730,618.69
	Për veprimet e thesarit dhe ndërbankare	10,022.17
	Nga veprimet me klientët	720,596.53
	Interesa për letrat me vlerë të blera sipas marrëveshjeve të rishitjes	0.00
	Të tjera	0.00
	Të ardhura nga veprimet me letrat me vlerë & veprimtaritë e tjera financiare	136,655.99
	Të ardhura nga bonot e thesarit	61,287.47
	Nga veprimet me letrat e tjera me vlerë	75,368.52
	Te ardhura nga letrat me vlere te vendosjes	75,086.73
	Te ardhura nga letrat me vlere te investimeve	281.79
703	Komisione për shërbime bankare	131,879.42
	Nga transaksionet me klientët	54,858.42
	Komisione për shërbimet bankare	72,775.60
	Komisione të tjera	4,245.39
706	Fitime nga veprimet me valutat	19,375.42
74	Transferime nga fondet rezervë për zhvlerësimin e Mj. të Qëndr.	0.00
75	Transferime nga fondet rezervë për zhvlerësimin e llogarive për t'u arkëtuar	349,767.05
	Fonde rezervë statistikore për huatë standarte dhe në ndjekje	25,767.53

	Standarte	4,087.70
	Në ndjekje	21,679.83
	Fonde rezervë për huatë nënstandarte, të dyshimta dhe të humbura.	323,999.52
	Nënstandart	35,058.37
	Të dyshimta	192,221.60
	Të humbura	96,719.56
76	Të ardhura të jashtëzakonshme	22,171.58
	Shlyerja e huave të regjistruara si hua të humbura	13,505.22
	Shlyerja e huave të humbura nga të tretët	0.00
	Të ardhura të tjera të jashtëzakonshme	8,666.36
79	Humbja e vitit në vazhdim	0.00
	TOTALI I TE ARDHURAVE	1,390,468.14

2.2. Treguesit e Rentabilitetit

Treguesit e perfitueshmerise dhe performances		
Numer	Treguesi	Vlera
i)	Kthyeshmëria nga aktivet mesatare	0.10
ii)	Rezultati neto i jashtëzakonshëm/aktivet mesatare	47.84
iii)	Shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë / të ardhurat bruto të veprimtarisë;	0.17
iv)	Të ardhurat neto nga interesi / shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë;	2.44
v)	Kthyeshmëria nga kapitali aksionar mesatar (ROAE) = të ardhurat neto /kapitali aksioner mesatar *100;	0.47
vi)	Aktive për punonjës = totali i aktiveve / numri i regjistruar i punonjësve	126,693.07
vii)	Të ardhurat neto nga interesat / aktivet mesatare;	0.02
viii)	Marzhi neto nga Interesat = Te Ardhura neto nga interesat/Aktive Mesatare qejellin te ardhura	0.01
ix)	Te ardhurat nga interesat / aktivet mesatare	0.02
x)	Shpenzime per Interesa/ aktivet mesatare	0.01
xi)	Të ardhurat neto nga interesat / të ardhurat bruto të veprimtarisë;	0.43
xii)	Të ardhurat neto nga veprimtaritë e tjera / aktivet mesatare;	-0.01
xiii)	Shpenzimet jo për interesa / të ardhurat bruto të veprimtarisë;	0.75
xiv)	Shpenzime personeli / të ardhurat bruto të veprimtarisë;	0.15
xv)	Shpenzime për provigjone / aktivet mesatare.	0.01

3. Struktura e kapitalit rregullator

Ne 30 Qershor 2015, struktura e kapitalit rregullator te Banka NGB Albania eshte si me poshte:

- Kapitali i paguar (i zotruar 100% nga NGB S.A)
- Primet e Aksioneve
- Fitimet e pashpendara

- Rezervat
- Borxhi I Varur dhe Instrumentat Hibrid

KAPITALI RREGULLATOR	
Zeri	Shuma
Instrumenta të kapitalit të njohura si Kapital Bazë i Nivelit të Parë (KBN1)	7,587,914.55
Kapitali i paguar	7,587,914.55
Fitimet e pashpërndara dhe humbjet e mbartura nga periudhat e mëparshme	-5,717,044.09
Fitimet e pashpërndara	-5,717,044.09
Rezervat (përveç rezervave të rivlerësimit)	453,866.47
Diferenca rivleresimi kreditore	487,570.47
(-) Rregullime të vlerës sipas kërkesave për vlerësimin prudent	57,988.16
Rregullime të KBN1 lidhur me filtrat prudencialë	-57,988.16
(-) Shuma bruto e aktiveve të tjera të patrupëzuara	34,299.14
(-) Aktive të tjera të patrupëzuara	-34,299.14
Kapital I Nivelit te Pare	2,720,020.08
Instrumenta të kapitalit të paguara plotësisht dhe borxhi i varur	1,360,010.04
Instrumentat e kapitalit dhe borxhi i varur të njohur si kapital i nivelit të dytë	1,360,010.04
Kapital I Nivelit te Dyte	1,360,010.04
<u>Kapitali Rregullator</u>	4,080,030.13

4. Mjaftueshmëria e Kapitalit

Banka e monitoron mjaftueshmerine e kapitalit te saj, pervec masave te tjera , nepermjet perdorimit te rregulloreve dhe raporteve te vendosura nga Banka e Shqiperise e cila percakton kapitalin rregullator te kerkuar per te mbeshtetur biznesin. Rregullorja “Mbi mjaftueshmerine e Kapitalit” eshte mbeshtetur ne ligjin No.8269 date 23.12.1997 mbi Banken e Shqiperise” dhe Ligji No.9662 date 18.12.2006 “Mbi Bankat e Republikes se Shqiperise” .

Raporti I Mjaftueshmerise se Kapitalit eshte raporti I kapitalit rregullator me aktivet e ponderuara me rrezikun dhe llogarite jashte bilancit I shprehur ne perqindje. Minimumi I Raportit te Mjaftueshmerise se Kapitalit qe kerkohe nga Banka e Shqiperise eshte 12% nderkohe qe Banka e ka mbajtur kete norme me 16.3% ne 30 qershor 2014.

Raporti I modifikuar I mjaftueshmerise se kapitalit eshte raporti I kapitalit baze me aktivet e ponderuara me rrezikun dhe llogarite jashte bilancit I shprehur ne perqindje.

KAPITALI RREGULLATOR	4,080,030
RMK (%)	16.3
SHUMA TOTALE E EKSPozIMEVE TE PONDERUARA ME RREZIK	25,017,305
RREZIKU I KREDISE	

Shuma e ekspozimeve të ponderuara me rrezik për rrezikun e kredisë, kundërpartisë, dhe rrezikun e shlyerjes së transaksioneve jo-DVP - Metoda Standarde (SA)	22,756,968
Klasat e ekspozimit sipas SA duke përfshiruar pozicionet e titullimit	22,756,968
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive qendrore ose bankave qendrore;	850,748
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive rajonale ose autoriteteve lokale;	-
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organeve administrative dhe ndërmarrjeve jo tregtare (organizatat joqeveritare/jofitimprurëse);	-
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj bankave shumëpalëshe të zhvillimit;	-
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organizatave ndërkombëtare;	-
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj institucioneve të mbikëqyrura;	1,509,223
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj shoqërive tregtare (korporatave);	4,648,926
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj portofoleve me pakicë (retail);	8,939,122
Ekspozime ose ekspozime të mundshme të siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme;	4,498,324
Ekspozime (kredi) me probleme;	1,570,155
Ekspozime ndaj kategorive të klasifikuara me rrezik të lartë;	-
Ekspozime në formën e obligacioneve të garantuara;	-
Ekspozime në formën e titujve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive SiK;	-
Zëra të tjerë	740,469
Pozicionet e titullimit SA	-
<i>nga të cilat: rritullzime</i>	
RREZIQET E TREGUT	
Shuma e ekspozimeve të ponderuara me rrezik për rreziqet e tregut	-
Shuma e ekspozimit me rrezik për rrezikun e shlyerjes	-
Rreziku i shlyerjes në librin e bankës	-
Rreziku i shlyerjes në librin e tregtueshëm	-
Shuma e ekspozimit me rrezik për rrezikun e pozicionit, kursit të këmbimit dhe mallrave (SA)	-
Rreziku i pozicionit të titujve të borxhit	-
Rreziku i pozicionit të instrumentave të kapitalit	-
Rreziku i kursit të këmbimit	-
Rreziku i investimeve në mallra	-
Shuma e ekspozimit të ponderuar me rrezik për rrezikun e përqendrimit në librin e tregtueshëm	-
RREZIKU OPERACIONAL	-
Shuma e ekspozimit të ponderuar me rrezik për rrezikun operacional	2,260,337
Metoda e Treguesit Bazik (BIA)	-
Metoda Standarde / Standarde Alternative	2,260,337
Shtesat për rritjen në klasat në "Veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare" dhe "Veprimet me letrat me vlerë" të jorezidentëve, në valutë	-
Totali i zërave të aktivitetit i "Veprimeve me thesarin dhe transaksionet ndërbankare" dhe "Veprimeve me letrat me vlerë" të jorezidentëve, në valutë, mars 2013	6,245,323
Totali i zërave të aktivitetit i "Veprimeve me thesarin dhe transaksionet ndërbankare" dhe "Veprimeve me letrat me vlerë", jorezidente në valutë në periudhën raportuese	4,681,489
Rritja e zërave të aktivitetit i "Veprimeve me thesarin dhe transaksioneve ndërbankare" dhe "Veprimeve me letrat me vlerë" të jorezidentëve, në valutë	(1,563,834)
Totali i zërave të pasivitetit i "Veprimeve me thesarin dhe transaksionet ndërbankare" dhe "Veprimeve me letrat me vlerë" të jorezidentëve, në valutë, mars 2013	40,370

Totali i zërave të pasivit i “Veprimeve me thesarin dhe transaksioneve ndërbankare” dhe “Veprimeve me letrat me vlerë” të jorezidentëve, në valutë, në periudhën raportuese	40,895
Rritja e zërave të pasivit i “Veprimeve me thesarin dhe transaksionet ndërbankare” dhe “Veprimeve me letrat me vlerë” të jorezidentëve, në valutë	525
Pakësimet për rritjen e portofolit të kredisë brenda vendit për vitin 2015	-
Portofoli i kredisë bruto, në dhjetor 2014	27,300,125
Portofoli i kredisë bruto, në periudhën raportuese 2015	23,428,828
Rritja e portofolit të kredisë, 2015	(3,871,297)
Rritja e portofolit të kredisë për 2015-ën, me bazë vjetore, sipas periudhës raportuese:	-
<i>nëse periudha raportuese është mars 2015</i>	-
<i>nëse periudha raportuese është qershor, 2015</i>	(7,742,595)
4% e portofolit të kredisë së dhjetorit 2014	1,092,005
10% e portofolit të kredisë së dhjetorit 2014	2,730,013

5. Informacion i përgjithshëm cilësor për ekspozimin ndaj rreziqeve

Divizioni I Menaxhimi te Riskut te Bankes ka si mision:

- Specifikimi dhe zbatimi i politikës mbi çështjet e rrezikut të kredisë, me theks kryesor në sistemet e vlerësimit, modelet e vlerësimit dhe parametrat e rrezikut në përputhje me udhëzimet e Bordit të Drejtorëve.
- Trajtimi metodike i këtyre çështjeve në kuadër të udhëzimeve dhe vendimeve të veçanta të Komitetit të Menaxhimit të Riskut të Bordit të Drejtorëve të Bankës.
- Dizajni, specifikimi, zbatimi dhe prezantimi i politikës në menaxhimin e fondeve, sipas udhëzimeve të Bordit të Drejtorëve të Bankës.
- Vlerësimi i përshtatshmërisë së metodave dhe sistemeve të identifikimit, për të matur dhe monitoruar rrezikun e kreditimit parashikuar nga Banka dhe vlefshmërinë e tyre periodike.
- Llogaritja e kapitalit rregullator dhe ekonomik që kërkohet për të mbuluar këto rreziqe.
- Krijimi i raporteve rregullatore dhe mbikëqyrëse.
- Planifikimi, specifikimi, rekomandimi dhe zbatimi i politikës në kredi, menaxhimin e rrezikut operacional dhe menaxhimin e rrezikut të likuiditetit, në përputhje me udhëzimet e Bordit të Drejtorëve të Bankës.
- Vlerësimi i përshtatshmërisë së metodave dhe sistemeve të identifikimit, matjes dhe monitorimit këto rreziqe marra përsipër nga Banka dhe vlefshmërinë e tyre periodike.
- Kryerja e vlerësimeve të pavarura të instrumenteve financiare dhe të aktiveve të tjera dhe detyrimeve të Bankës.
- Funksionimi i rregullt i çështjeve, që lidhen me rrezikun financiar, operacional dhe të likuiditetit brenda udhëzimeve dhe vendimeve të veçanta të Komitetit të Menaxhimit të Riskut të Bordit të Drejtorëve të Bankës.
- Drejtorëve dhe aseteve Detyrimet Komiteti (ALCO) të Bankës.
- Bashkëpunimi i ngushtë me Divizionin e Menaxhimit të Rrezikut të Grupit NGB në të gjitha çështjet , në mënyrë që të arrijë unitetin e politikave dhe procedurave te grupit me strategjine.

6. Rreziku i kredisë: Informacion i përgjithshëm

6.1 Teprica bruto e kredise sipas llojeve kryesore te ekspozimeve te kredise

Lloji I Kredise	Teprica Bruto Qershor 2015 (Mije Lek)	Teprica Mesatare Bruto per 3-mujorin (Mije Lek)
Kredi Biznesi	7,788,155.13	10,025,092.31
Kredi Biznes I Vogel	483,536.75	504,762.21
Kredi per Shtepi	13,565,884.89	14,304,598.23
Kredi Konsumatore	1,301,314.55	1,331,731.10
Kredi per Autovetura	2,428.03	2,643.16
Karte Krediti	23,786.58	23,445.26
Overdraft	263,721.86	275,490.54
Totali	23,428,827.78	26,467,762.82

6.2 Klasifikimi i portofolit te kredive sipas shperndarjes gjeografike

Rrethi	Teprica e Kredise Qershor 2015	
	(Mije Lek)	
Tirane		16,361,738.35
Durres		2,876,300.48
Elbasan		279,468.97
Shkoder		169,622.04
Korce		438,978.23
Vlore		550,492.40
Lushnje		558,892.43
Gjirokaster		325,480.73
Fier		361,072.40
Berat		87,477.22
Pogradec		191,905.21
Sarande		222,734.74
Kukes		96,066.87
Lezhe		758,102.02
Kavaje		150,495.70
Totali		23,428,827.78

6.3 Klasifikimi i portofolit te kredive sipas sektoreve te ekonomise

Evidenca e kreditit sipas degëve të ekonomisë	
Deget e Ekonomise	Teprica e kredisë Qershor 2015(Mije Lek)
Bizneset	8,014,019.45
Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	24,280.46
Industria përpunuese	1,852,309.05

Prodhimi, shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit dhe e ujit	94,947.07
Ndërtimi	1,123,251.30
Tregtia, riparimi i automjeteve dhe artikujve shtëpiak	3,144,144.74
Hotelet dhe restorantet	560,555.82
Transporti, magazinimi dhe telekomunikacioni	180,816.32
Pasuritë e patundshme, dhënia me qira etj.	6,848.24
Arsimi	67,887.66
Shëndeti dhe veprimtaritë sociale	152,240.29
Shërbime kolektive, sociale dhe individuale	797,043.37
Të tjera	9,695.13
Individët	15,414,808.33
Totali	23,428,827.78

6.4 Klasifikimi I portofolit te kredive sipas Sektoreve te ekonomise dhe maturitetit te mbetur

Evidenca e kreditit për ekonominë sipas maturitetit te mbetur	Teprica e kredisë në fund te muajit (Mije Lek)
Kredi afatshkurtër	3,801,778.21
<i>Lekë</i>	786,686.98
<i>Valutë</i>	3,015,091.23
Kredi afatmesme	3,627,621.02
<i>lekë</i>	862,307.99
<i>Valutë</i>	2,765,313.02
Kredi afatgjatë	15,999,428.55
<i>Lekë</i>	2,133,707.11
<i>Valutë</i>	13,865,721.44
Totali	23,428,827.78

6.5 Klasifikimi I Kredive dhe Shpenzimet per provigjonet sipas industries (kredite me problemere)

Degët e ekonomisë	Teprica e kredise ne fund te muajit per kredite me problem	Shpenzimet per provigjone
D. Industria perpunuese	1,261,648.54	914,836.44
F. Ndertimi	817,669.04	770,486.05
G. Tregtia, Riparimi i Automobilave dhe Artikujve Shtepiake	893,534.08	702,935.96
H. Hotele dhe restorante	265,889.32	208,699.10
I. Transporti Magazinimi dhe telekomunikacioni	15,705.53	3,309.71
K. Pasurite e patundshme ,dhenia me qera etj	6,848.24	4,315.37
N. Shendeti dhe veprimtarite sociale	108,162.42	108,162.42
Z. Individe	1,764,014.28	1,188,754.39
Totali	5,133,471.45	3,901,499.44

6.6 Klasifikimi I kredive dhe shpenzimet per provigjone sipas shperndarjes gjeografike (kredite me probleme)

Rrethi	Teprica e kredise ne fund te muajit per kredite me probleme	Shpenzimet per provigjone
A.Tirana	3,867,620.22	3,060,817.62
B.Durres	808,845.08	559,351.29
C.Elbasan	30,957.51	15,151.15
D.Shkoder	2,706.70	2,698.66
E.Korce	71,160.18	26,892.45
F.Vlore	127,008.53	111,980.94
G.Lushnje	40,277.49	18,129.35
H.Gjirokaster	24,060.91	5,513.95
I.Fier	68,434.09	42,180.37
J.Berat	10,396.67	10,384.67
K.Pogradec	17,598.05	10,785.20
L.Sarande	22,887.91	10,381.32
LL.Kukes	1,263.68	1,050.19
M.Lezhe	38,743.74	25,331.44
N.Kavaje	1,510.69	1,329.70
Totali	5,133,471.45	3,901,978.29

6.7 Ndryshimet ne Fondet rezerve per humbjet nga kredite gjate periudhes

Fondet Rezerve te Krijua nga Banka	Teprica në fillim	Shtimi i provigjoneve	Rimarrje e provigjoneve	Kreditë e fshira gjatë periudhës	Teprica në fund
FR për mbulimin e humbjeve nga huatë nënstandarde	178,475.79	10,162.03	29,337.24	-	159,300.58
FR për mbulimin e humbjeve nga huatë e dyshimta	619,867.66	105,941.88	46,316.48	-	679,493.06
FR për mbulimin e humbjeve nga huatë e humbura	7,884,133.58	16,929.45	53,291.42	4,784,586.97	3,063,184.64
FR për rreziqe e shpenzime	646,724.24	-197,377.11	12,851.83	-	436,495.31
Totali	9,329,201.28	-64,343.75	141,796.97	4,784,586.97	4,338,473.60

7. Rreziku i kredisë : Informacion për portofolin e kredisë sipas metodës standard

Lista e ECAI te cilat mund te perdoren nga Banka:

1. Moody's
2. Fitch
3. Standard and Poor's
4. Japan Credit Rating (JCR)

Banka aktualisht perdor per qellime te mjaftueshmerise se kapitalit tre agjensite e para te rating.

8. Teknikat e zbutjes së rrezikut

- i) Teknika e ndjekur nga Banka NBG Albania SH.A per zbutjen e riskut konsiston ne nje program specifik “ Mitigimi I Riskut”. Ky program aplikohet ne rastet kur klientet : kane probleme financiare, jane te papune, kane probleme shendetsore, kane reduktim te te ardhurave, etj; dhe per te gjitha llojet e kredive individuale. Nese nje klient trajtohet me kete program rishikohet aftesia paguese, ekspozimi ne sistemin bankar dhe rishikimi i garancive ne terma cilesore dhe sasiore.
- ii) Vleresimi I kolateralit/ve kryhet nga nje vleresues I pavarur dhe I licencuar. Lista me vleresuesit e jashtem aprovohet nga autoritetet perkatese te bankes dhe publikohet. Te gjitha raportet e vleresimit jane subject rishikimi nga struktura e brendshme e bankes, pergjegjese per kete.
- iii) Tipet e kolateraleve te pranueshme per Banka NBG Albania Sh.A jane si me poshte vijon:
 - a. Garancite financiare: depozita, L/G,etj
 - b. Pasuri te patundshme :
 - ◇ Prona rezidenciale dhe komerciale;
 - ◇ Toka qe ndodhen ne zona urbane, me leje ndertimi ose plane urbanistike te aprovuara.
 - c. Pasuri te tundshme si : pengu, etj.
- iv) LLojet e Garanteve te perfshire ne kredite individuale jane:
 - a. Garant financiar, nga pikepamja e aftesise paguese konsiderohet si pjese e pandare e detyrimit te pageses se detyrimeve qe lidhen me kredine ne te cilen perfshihet dhe garanton shlyerjen me cdo pasuri te tij.
 - b. Garant hipotekor, garanton shlyerjen e kredise vetem me pronen/at te cilat sherbejne si garanci per kredine.

9. Rreziqet e tregut: Informacion i përgjithshëm

Banka llogarit risk tregu vetem per pozicionin e hapur valuator e. Ne baze te rregullores per mjaftueshmerine e kapitalit banka llogarit kerkesa per capital ne lidhje me riskun e tregut nese pozicioni valuator eshte me shume se 2% e kapitalit rregullator.

10. Rreziku operacional

- a. Rreziku operacional është rreziku i humbjes financiare si rezultat i papërshtatshmërisë ose dështimit të proceseve të brendshme, sistemeve, gabimeve njerëzore, ose i ngjarjeve të jashtme. Rreziku operacional përfshin rrezikun ligjor, por përjashton rrezikun reputacional dhe atë strategjik.
- b. Drejtimi i riskut operacional bëhet në përputhje me politikat e procedurat e brendshme të Bankës, si edhe në përputhje me kërkesat e rregullores Nr. 03 datë 19/01/2011 “Për administrimin e rrezikut operacional”.

- c. Politikat dhe procedurat e bankës për menaxhimin e rrezikut operacional kanë si qëllim të sigurojnë që të gjitha palët e interesuara duke përfshirë bordin e drejtorëve, drejtuesit gjithashtu dhe stafin, menaxhojnë rrezikun operacional brenda nje kuadrit të formalizuar dhe i harmonizuar me objektivat e bankës.
- d. Në përputhje me kuadrin e brendshëm dhe atë rregullator, Banka ka zhvilluar procedura dhe sisteme të cilat bëjnë të mundur identifikimin, vlerësimin dhe raportimin e ngjarjeve të rrezikut operacional. Banka analizon dhe i klasifikon humbjet operationale sipas linjave të biznesit. Gjithashtu, Banka raporton cdo tre muaj treguesit kyc të rrezikut operacional bazuar ne rregulloren “Për administrimin e rrezikut operacional”.
- e. Banka përdor metoden standarte per llogaritjen e kërkeses për kapital ne lidhje me rrezikun operacional.

11. Rreziku i likuiditetit


Menaxhimi i rrezikut te likuiditetit bëhet në përputhje me politikat e brendshme të Bankës si edhe në përputhje me rregulloren e Bankës së Shqipërisë Nr.71 datë 14/10/2009 “Për administrimin e rrezikut të likuiditetit” ndryshuar me vendimin nr.08, datë 12.02.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Niveli i aktiveve likuide në bilanc reflekton qasjen e kujdeshme të politikave dhe praktikave të ndjekura nga banka për menaxhimin e likuiditetit. Banka përgjat tremujorit të dytë ka ruajtur nje nivel të kënaqshem të treguesit të likuiditetit, i cili është mbi nivelin e kërkuar nga Banka se Shqipërisë.

TREGUESI I LIKUIDITETIT						(në %)
1	Aktive likuide / pasive afatshkurtra * 100 (per monedhen kombetare LEK)					29.53
2	Aktive likuide / pasive afatshkurtra * 100 (per monedhat e huaja)					47.93
3	Aktive likuide / pasive afatshkurtra * 100 (ne total)					39.78
Aktive Likuide- Pasive Afatshkurtra						
(Mije Lek)						
		LEKË	USD	EUR	TË TJERA	TOTALI
	Arka	496,968.55	206,277.73	424,146.82	14,723.74	1,142,116.85
	Llogaritë me Bankën e Shqipërisë, duke përfshirë rezervën e detyrueshme deri në masen e lejuar te perdorimit te saj, te percaktuar me akt nenligjor te Bankes se Shqiperise	373,628.77	605.98	1,403,430.93	-	1,777,665.68
	Bonot e thesarit të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, të regjistruara në bilanc si “të tregtueshme”/“të vendosjes”	2,694,313.12	-	95,781.88	-	2,790,095.00
	80 për qind të obligacioneve të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë të regjistruara në bilanc si “të tregtueshme”/“të vendosjes”	80,247.65	-	583,440.87	-	663,688.52
	Llogaritë rrjedhëse në bankat dhe institucionet e tjera financiare **	10.79	174,718.68	1,320,284.08	83,712.02	1,578,725.57

	Depozita me bankat dhe institucionet e tjera financiare me maturim të mbetur deri në 7 (shtatë) ditë	-	-	1,964,060.00	-	1,964,060.00
	Letra me vlerë "të tregtueshme"/"të vendosjes" të emetuara nga institucione financiare me vlerësim nga agjencitë ndërkombëtare të rating-ut ekuivalente me klasifikimin e S&P jo më pak se A+;	-	1,163,329.58	-	-	1,163,329.58
A	Totali I Aktiveve Likuide	3,645,168.88	1,544,931.98	5,791,144.58	98,435.77	11,079,681.20
B	Totali I Pasiveve Afatshkurtra me afat te mbetur maturimi deri ne 1 Vit	12,345,410.52	1,097,623.05	14,302,972.90	109,402.37	27,855,408.84

Trendi i Liquiditetit



12. Depozita ekuivalente e kapitalit të degës së bankës së huaj

Nr.	Depozita ekuivalente e kapitalit (DEK)	Shuma (Mije Lek)
1 .	Depozite ne Banken e Shqiperise me norme interesi te percaktuar me marreveshje midis tyre	1,087,438.02
2 .	Bono thesari dhe obligacione te emetuara nga Keshilli I Ministrave I Republikes se Shqiperise	6,084,299.57
3 .	Tituj te emetuar nga Banka e Shqiperise	
	Shuma	7,171,737.60

13. Matja dhe kontrolli i kufijve të rrezikut të degës së bankës së huaj

Kodi	Treguesit	Shuma (Mije Lek)
1	Totali I aktiveve ne fund te tremujorit paraardhes	38,701,237.28
2	Teprica e kredise e tremujorit raportues	23,428,827.78
3	Raporti teprice kredie / total I aktiveve(ne %) (2:1*100)	60.54%
4	Kufiri maksimal I rrezikut	70%

14. Politikat kontabël

Pasqyrat financiare të Bankës janë përgatitur në përputhje me “Metodologjinë e raportimit dhe përmbajtjen e raporteve financiare” (“Metodologjia e Raportimit Financiar” ose “MRF”) e miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë më 24 dhjetor 2008. MRF u miratua për qëllime rregullatore, në zbatim të Nenit 47 të Ligjit nr. 9662, datë 18 dhjetor 2006 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”.

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

Përmbledhje e parimeve bazë kontabël

14.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në LEK sipas kursit të këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj, të deklaruara me kosto historike, konvertohen sipas normës së këmbimit të fundvitit. Diferencat nga konvertimi paraqiten në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Aktivët dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj, të deklaruara me kosto historike konvertohen sipas normës së këmbimit në datën e transaksionit.

Kapitali i paguar është trajtuar si një zë monetar dhe është rivlerësuar në përputhje me parimin e shpjeguar më sipër. Sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë, kapitali në monedhë të huaj duhet të paraqitet në bilanc i konvertuar me kursin e këmbimit në datën e transaksionit dhe një “rezervë rivlerësimi” e krijuar në kapitalin e aksionarëve që përfaqëson diferencën në Lek ndërmjet kursit të fundit të periudhës me kursin historik që përdoret për të regjistruar kapitalin e paguar në monedhë të huaj.

14.2 Arka dhe llogaritë me Bankën Qendrore

Arka dhe llogaritë me Bankën Qendrore përfshijnë kartëmonedha dhe monedha në arkë dhe gjendje të pakushtëzuara në bankat qendrore, subjekt i një rreziku jo domethënës ndaj ndryshimeve në vlerën e tyre të drejtë, dhe përdoren nga Banka në administrimin e angazhimeve afatshkurtra. Arka dhe llogaritë me Bankën Qendrore mbahen në pasqyrën e bilancit të me kosto të amortizuar.

14.3 Depozita dhe llogaritë me bankat

Depozitat dhe llogaritë me bankat përfshijnë depozita ndërbankare dhe zëra që janë në procesin e arkëtimit.

14.4 Letra me vlerë të vendosjes

Letrat me vlerë të vendosjes paraqiten me vlerën e tregut, me interesin e përlllogaritur për kuponin e paguar. Çdo zbritje apo prim i paguar për vlerën nominale në momentin e transferimit përlllogaritet deri në ditën e pagesës së letrës me vlerë të vendosjes. Letrat me vlerë të vendosjes pas regjistrimit fillestar, maten me vlerë të drejtë. Këto letra me vlerë paraqiten si të vendosjes sepse Banka ka qëllimin t’i rishesë përpara maturimit.

14.5 Letra me vlerë të mbajtura deri në maturim

Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim përfshijnë Bonot e Thesarit. Investimet që kanë pagesa fikse ose të përcaktuara për të cilat Banka ka synimin e qartë dhe aftësinë për t'i mbajtur deri në maturim, dhe të cilat nuk janë përcaktuar si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes ose si të vlefshme për shitje.

Investimet që mbahen deri në maturim paraqiten me koston e amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv, të pakësuar me humbjet e mundshme nga rënia në vlerë.

Çdo skonto ose prim i paguar mbi vlerën nominale në momentin e blerjes përlogaritet deri në datën e pagesës së principalit të letrës me vlerë.

14.6 Matja e vlerës reale

Meqenëse nuk ekziston tregu financiar për instrumentet financiare të krijuara në Shqipëri, vlera reale bazohet mbi gjykimet në lidhje me përvojën e humbjeve të pritshme në të ardhmen, kushtet aktuale ekonomike, karakteristikat e rrezikut të instrumenteve të ndryshme financiare dhe faktorëve të tjerë. Matja e vlerës reale bazohet në instrumentet financiare ekzistuese në bilanc, pa u përpjekur për të matur vlerën e parashikuar të biznesit në të ardhmen dhe vlerën e mjeteve e detyrimeve që nuk konsiderohen instrumente financiare. Mjetet dhe detyrimet që nuk konsiderohen instrumente financiare përfshijnë kryesisht: aktivet e qëndrueshme dhe depozitat

14.7 Hua dhe paradhënie për klientët

Huatë dhe paradhëniet për klientët paraqiten me vlerën e tyre neto me provigjionin për humbje specifike. Provigjionet janë krijuar në përputhje me politikat huadhënëse të Bankës e cila është në përputhje me ligjet në fuqi (Ligji për Bankat dhe Rregullorja e Bankës së Shqipërisë “Për Administrimin e Rrezikut të Kredisë” miratuar me Vendimin Nr. 52, datë 14 korrik 2004, ndryshuar me Vendimin Nr.101, datë 27 dhjetor 2006, ndryshuar me Vendimin Nr. 31, datë 30 prill 2009, ndryshuar me Vendimin Nr. 59 dhe Nr. 61, datë 29 gusht 2008, ndryshuar me Vendimin Nr. 47, datë 10 qershor 2009, ndryshuar me vendimin Nr. 62 date 14.09.2011 dhe ndryshuar me vendimin 27 date 27.03.2013 të Këshillit Mbikqyrës së Bankës së Shqipërisë).

Rregullorja kërkon që Banka të klasifikojë kreditë në pesë kategori rreziku.

Banka për secilën kategori rreziku aplikon normat e mëposhtme për krijimin e fondeve rezervë: Tipi i huasë	Ditë vonesat	Fondi rezervë
Standarte	0-30 ditë	1-10%
Në ndjekje	31-90 ditë	5-10%
Nën standarte	91-180 ditë	20%
E dyshimtë	181-365 ditë	50%
E humbur	Mbi 365 ditë	100%

Sipas ndryshimit të fundit të kësaj rregulloreje, në rastet kur kredia para rishturimit klasifikohet në kategorite “standarte” ose “në ndjekje” nëse rishturohet për herë të parë duhet të ruajë të njëjtën klasë dhe për të krijohe fonde rezervë për mbulimin e humbjeve të mundshme nga kreditë, me një normë jo më të vogël se 10 (dhjetë) për qind për kryegjënë dhe interesin.

Huatë dhe paradhëniet për klientët paraqiten me vlerën e tyre neto pasi zbritet provigjioni për humbje specifike nga huatë për kreditë e klasifikuara si nën-standarte, të dyshimta dhe të humbura. Rezerva për

humbjet potenciale nga huatë e klasifikuara si standarte dhe në ndjekje regjistrohet në pasqyrën e bilancit si detyrim i Bankës.

14.8 Aktive të patrupëzura

Aktivet e patrupëzuara lidhen me programet informatike të blera, shpenzimet e nisjes së biznesit dhe marka tregtare që regjistrohen me koston e tyre historike dhe amortizohen për një periudhë pesë vjeçare, duke përdorur metodën lineare të amortizimit.

14.9 Aktive të trupëzura

Aktivet e trupëzuara paraqiten duke zbritur zhvlerësimin e akumuluar nga vlera e tyre bruto. Përlllogaritja e amortizimit bëhet me metodën lineare. Toka nuk zhvlerësohet. Normat vjetore të zhvlerësimit janë si më poshtë: Kategoria	Norma vjetore
Makineri dhe pajisje	10 - 25%
Pajisje zyre	10 - 20%
Përmirësim i ambienteve me qira	10 - 35%

14.10 Të ardhura dhe shpenzime nga interesat

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në bazë të metodës së interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që skanton pagesat dhe arkëtimet e ardhshme monetare gjatë jetës së aktivit ose detyrimit financiar (ose kur është e përshtatshme një periudhë më e shkurtër) për t'i barazuar me vlerën kontabël të aktivit ose detyrimit financiar.

Për llogaritjen e normës efektive të interesit, Banka vlerëson flukset monetare të ardhshme duke marrë parasysh të gjitha kushtet kontraktuale të instrumentit financiar, por jo humbjet e ardhshme.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha komisionet e paguara ose të marra të cilat janë një pjesë përbërëse e normës efektive të interesit. Kostot e transaksioneve janë kosto shtesë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen ose emetimin e një aktivi apo detyrimi financiar.

14.11 Të ardhura dhe shpenzime nga komisionet dhe tarifat

Të ardhurat dhe shpenzimet nga komisionet dhe tarifat rrjedhin nga shërbimet financiare që përfshijnë transfertat, aktivitetin huadhënës, komisionet për mbajtje llogarie, aktivitetin financiar tregtar dhe huadhënës. Të ardhurat dhe shpenzimet nga komisionet dhe tarifat njihen kur shërbimi korrespondues është kryer apo përfituar.

14.12 Tatimi

Banka përcakton shumën e tatueshme në fund të vitit në përputhje me legjislacionin Shqiptar të tatimeve. Në vitin 2014, tatimi mbi fitimin është i barabartë me 15% të fitimit të tatueshëm. Fitimi i tatueshëm llogaritet duke modifikuar fitimin para tatimit për zëra të caktuar të ardhurash dhe shpenzimesh në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Banka beson se shpenzimet e saj të përlllogaritura për detyrime tatimore janë të përshtatshme për të gjithë vitet tatimore duke e bazuar vlerësimin e saj në shumë faktorë, përfshirë dhe interpretimin e legjislacionit tatimor dhe përvojat e mëparshme. Ky vlerësim mbështetet në vlerësime dhe supozime dhe mund të përfshijë

disa gjykime për ngjarje të ardhshme. Informacione të reja që mund të bëhen të ditura, mund të bëjnë që Banka të ndryshojë vlerësimin e saj për përshtatshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; këto ndryshime do të ndikojnë shpenzimin tatimor në periudhën që bëhet përcaktimi.